

Komuna e Skënderajt/Srbica

Hysen (Nezir) Mangjoli

(5.01.1947, shqiptar nga Mikushnica/Mikušnica, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, tetë fëmijë)

Hyseni me familje jetonin në Mikushnicë/Mikušnica. Punonte në Fabrikën e Tjegullave *Ardhmëria/Budučnost* në **Skënderaj/Srbica**. Në mëngjesin e datës **22.01.1998**, si zakonisht nga ora 07:30, Hyseni u nis në punë. Me të u nisën edhe i vëllai Haku dhe djali i axhës, Bujari, të cilët u nisën në qytet për të blerë disa gjësende. Në udhëkryqin te *Mëhalla Jashari*, në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze, për të arritur me kohë në punë Hyseni e mori një rrugë shkurtore pranë Fabrikës së Municionit, ku gjendej policia serbe. Pesë minuta më vonë, Haku dhe Bujari kanë dëgjuar disa të shtëna. Në mbrëmje, kur u kthyen në fshat, mësuan nga komshiu Hajriz Islami se Hysenin e kishin vrarë. Pranë rrethojës së fabrikës, e kishte gjetur Maliq Muharremi. Po atë ditë, familjarët e kanë bartur trupin e pajetë të Hysenit në shtëpi. Hysenin e kanë varrosur ditën e nesërme në varrezat e *Mëhallës Mangjoli*.

Burimet: deklarata B.M, FDH-16632; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 6, FDH-23807.

Murat (Smajl) Dajaku

(3.01.1960, shqiptar nga Rakinica/Rakitnica, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtime, katër fëmijë)

Murati e kishte mbaruar Shkollën e Lartë Komerciale. Para lufte, ka punuar për disa vjet si punëtor ndërtime në Lubjanë.

Pas kthimit në Rakinicë/Rakitnica, punonte si murator dhe, njëherësh, e punonte tokën e vetë. Në datën **20.02.1998**, u nis për në Skënderaj/Srbica për disa pjesë për traktor. I vëllai Rrustemi e ka përcjell deri te udhëkryqi, ku Murati e ndali kamionin me targa të Mitrovicës/Kosovska Mitrovica. Kamionin e ngiste Milan Miletic. Rreth orës 13:30, përderisa po kalonin nëpër **Llaushë/Lauša**, persona të armatosur kanë hapur zjarr ndaj kamionit. E kanë plagosur Muratin në kraharor. Pasdite, banorët e Llaushës/Lauša e kanë gjetur Muratin e alivanosur pranë rrugës së fshatit. E bartën në spitalin e Skënderajt/Srbica, ndërkaq më vonë e transferuan në spitalin e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica. Një ditë më vonë, ai ndërroi jetë nga pasojat e plagosjes. E kanë varrosur më 25.02.1998 në varrezat e Rakinicës/Rakitnica.

Burimet: deklarata A.D, FDH-17315; deklarata Z.Đ, FDH-468; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 129, FDH-23807; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, II, 758; SMIP, *Teroristički...*, III, 16, 909; *Teroristi mučili i ubili 67 neđužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Milorad (Dimitrije) Ristić

(16.03.1945, serb nga Gjakova/Đakovica, autoelektricitist, katër fëmijë, pensionist)

Miloradi u nis më 19.02.1998 për në Krallëvë, për ta kontrolluar shtëpinë që e kishte atje. Udhëtonte me kumbarën Zdravko Đuričić, i cili për ndërmarrjen *KIB Orvin*